



ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

01-Nr- 016 - 3817

Me date 20.01.2026

Në bazë të nenit 13 dhe 58, të Ligjit Nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008", nenit 30 dhe 45 të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, të datës 04.11.2008, e ne mbështetje të nenit 11, paragrafi 2 lidhur me paragrafin 3, të Rregullores për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një (1) vit të pronës së paluajtshme të Komunës, 01-Nr-016-20161 të datës 30.03.2021, Kryetari i Komunës nxjerr këtë:

V E N D I M

Për formimin e komisionit të ankesave

1. Formohet komisionit për shqyrtimin e ankesave të cilat parashtrohen kundër vendimit të vlerësimit të komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave që janë parashtruar nga personat fizik dhe juridik për marrjen e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim për më pak se një (1) vit në këtë përbërje;

- | | | |
|-----|-------------------------|----------|
| 1.1 | Emrush BYTYQI----- | kryesues |
| 1.2 | Refki GOLLOPENI----- | anëtar |
| 1.3 | Bukurije KRASNIQI ----- | anëtare |
| 1.4 | Shqipron BYTYQI ----- | anëtar |
| 1.5 | Adelina SELIMAJ----- | anëtare |

2. Detyrë dhe përgjegjësi e komisionit për shqyrtimin e ankesave është që të vendos lidhur me ankesat të cilat parashtrohen kundër vendimit të vlerësimit të komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave që janë parashtruar nga personat fizik dhe juridik, për marrjen e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim për më pak se një (1) vit.

3. Mandati i komisionit për shqyrtimin e ankesave është dy (2) vite.

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.



Kryetari i Komunës

Bali MUHARREMAJ

Te njoftohet;

Drejtoria e urbanizmit

Drejtoria e pronës

Drejtoria e kulturës

Drejtoria shërbimeve publike

Komisioni

Arkiva